# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-451104**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Aksion në Korçë, 3 të rinj arrestohen duke trafikuar 6 kg drogë me makinë! Ja çfarë u sekuestrua tjetër gjatë kontrollit |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/aksion-ne-korce-3-te-rinj-arrestohen-duke-trafikuar-6-kg--me-makine-i586595` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 07:00:51 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 07:30:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `a044a632a7cf58a6b2c5e3d0f382b95d82dfd5cb8e082881704088006877b619` |
| TEKSTI | `aefe9921eb4a7275505a2067635d9c8329347157e123e038efaae3a5bf7e02a6` |
| PAMJA | `ef6fc14c3390ad416497c9f596d10dc8cbee8034316a7f9ea99523e78c892598` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `0d9f49100674fd29b88d5da00c3b3194ce5d532d15c424a202b55518f83b0666` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/0d9f49100674fd29b88d5da00c3b3194ce5d532d15c424a202b55518f83b0666`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

English

Te fundit FOTOT/ Kim Kardashian dhe Hamilton arratisje romantike në Liqenin e Komos, çifti fotografohet në një varkeShqiptaria në zi, Beogradi në festePërleshje me thika pran

# Aksion në Korçë, 3 të rinj arrestohen duke trafikuar 6 kg drogë me makinë! Ja çfarë u sekuestrua tjetër gjatë kontrollit

TemA
17 Shtator 2026, 09:30Kronika TEMA



Policia e Korçës finalizoi një operacion antidrogë, duke arrestuar 3 persona të dyshuar, ndërsa janë sekuestruar rreth 6 kilogramë lëndë narkotike të dyshuar cannabis sativa.

Operacioni është zhvilluar mbrëmjen e djeshme nga Strukturat e Hetimit të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë.

Sipas burimeve, në pranga kanë rënë tre të rinj, dy prej tyre me origjinë nga Tirana dhe një nga Lezha, të cilët dyshohet se po transportonin lëndën narkotike me automjet.

Tre personat udhëtonin së bashku në një makinë, e cila është ndaluar nga policia në afërsi të Qafë Thanës. Gjatë kontrollit të automjetit, në pjesën e bagazhit është gjetur një sasi prej rreth 6 kilogramësh lëndë narkotike.

Ndërkohë, gjatë kontrollit të njërit prej pasagjerëve është gjetur edhe një qese tjetër me lëndë narkotike, e cila mbahej në xhep.

Përveç lëndës narkotike, policia ka sekuestruar në cilësinë e provës materiale edhe automjetin, një shumë parash në euro dhe lekë, si dhe disa aparate celularë.

Hetimet vijojnë për dokumentimin e plotë të aktivitetit të dyshuar kriminal dhe përcaktimin e rolit të secilit prej tre personave të arrestuar.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Përleshje me thika pranë shëtitores në Sarandë, tre persona mbeten të plagosur! Policia nis hetimet]

08:40 Kronika

Arrestohet në Tiranë Eno Agasi, kushëri i biznesmenit Ergys Agasi

20:30 Kronika

Plagoset me armë zjarri avokati në Durrës, policia në kërkim të autorit, zbardhen emrat

19:41 Kronika / 1 koment

Plagosje me armë zjarri te "Vollga", i plagosuri dërgohet në spital, policia në kërkim të autorit

18:32 Kronika

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.